

**VENDIM**  
**Nr.440, datë 16.4.2008**

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË NJË KONVOJI USHTARAK ITALIAN, PËRMES  
TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e kalimit transit të një konvoji ushtarak italian, të përbërë nga 14 (katërmëdhjetë) automjete dhe 22 (njëzet e dy) trupa, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datën 21 prill 2008.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është Porti i Durrësit.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Konvoji ushtarak italian, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohet nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**